




Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	16.04.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHCK	1843/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 141/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe, Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 141/2021, të datës 16.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fsh. Pozhoran, Rr."Idriz Halabaku", PN, Komuna e Vitisë, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen administrative - juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr. 141/2021 e datës 16.03.2021 e parashtruar nga Ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Udhëheqës në Laboratorin e Masës, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, me datë 16.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1164/2021 të regjistruar me numër A.nr 141/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e pagesës së shtesave mbi pagën bazë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2007 të Qeverisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 19.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë. Këshilli me datë 26.03.2021 përmes shkresës me numër protokoll 1419/2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, administroje këto prova: Ankesën A nr. 141/2021, e datës 16.03.2021,

drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit, të datës 02.12.2019, Përshkrimin e detyrave të Punës për ankuesin

Diplomë universitare me nr.212 të datës 05.07.2006; shtojcë diplome, shkresë me nr. protokollin 9874 të datës 09.12.2019, e-mailin e datës 12.03.2021, të Menaxheres së Personelit drejtuar A.A etj, se bashku me e-mailat nga fq.1 deri 2, Vendimi Nr.02/38 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; përshkrim lidhur i vendeve të punës në gjuhën angleze i datës 01.06.2016, Dokument No.P193795/2 nga faqe 2 deri 7, Test Report numër 201.20/1640976 faqe 1 deri 3, dokument HMI-KMI 2016, Certifikatë trajnimit "Trajnim par Auditor të Jashtëm" nga data 28.09-02.10.2015, Certifikatë trajnimi për ankuesin: certifikatë për trajnimin "training on Calibration of masës" nga data 30.03.3015-03.04.2015, Certifikatë trajnimi "implementimi i sistemit relevant kualitativ për të mbështetur akreditimin", Certifikatë trajnimi për datat 23-27 mars, Certifikatë trajnimi për datat 09-13.02.2015, Certifikatë trajnime për datat 31.08.2015-04.09.2015; Certifikatë trajnimi për datat 26-30.10.2015, Certifikatë trajnimi të datave 26-30.10.2015, Certifikatë Trajnimi për datat 08-12.06.2015, Certifikatë trajnimi për datat 02-06.11.2015, Certifikatë Trajnimi për datat 19-23.01.2015, Certifikatë nga Qi Quality Infrastructure the Ëestern Ballkans për datat 17-19.05.2017, certifikatë trajnimi për data 02-06.02.2015, Certifikatë trajnimi nga data 07-11.12.2015, Certifikatë trajnimi nga data 3-5.10.2019, Certifikatë trajnimi nga data 26-30.01.2015, Certifikatë trajnimi nga data 23-27 mars, Certifikatë trajnimi nga data 23-26.02.2015, Certifikatë trajnimi nga data 22-26.06.2015, Përgjigje në ankesës e datës 26.03.2021, me numër protokollin 1419/2021, Lista e Titujve e Punonjësve që do të jenë Përfitues të Masës Stimuluese.03.2021; e-maili i datës 25.03.2021 i ankuesit drejtuar Udhëheqëses së Personelit, E-maili i datës 12.03.2021 nga A.D drejtuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, E-maili i datës 12.03.2021 i DMZP.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Ndryshim dhe Plotësim Aktin e Emërimit të datës 02.12.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Udhëheqës në Laboratorin e Masës, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, në kuadër të Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Udhëheqësja e Personelit të Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 12.03.2021 i është drejtuar me kërkesë Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë (me tej DMZP) , lidhur me të drejtën e shtesave mbi pagën bazë sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.02/39 të datës 08.10.2008. Po në të njëjtën datë DMZ ka ofruar përgjigje në kërkesën e Udhëheqëses së Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me sqarimin se ende nuk është themeluar Komisioni gjegjes për shqyrtimin e kërkesave të institucioneve të Shërbimit Civilë lidhur me kompensimin e shtesave mbi pagën bazë të çfarëdo natyre qofshin ato.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë

për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.07/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analize që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.141/2021

Rushit KAJTAZ

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik/MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

